ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**701-25-1066-1-2-1**
Nr i brendshëm	**701-25-015-121**

Sa i përket tenderit për: **"Furnizim me material medicinal" , Lot 1.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

MESE PHARM SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Magjistralja Prishtine - Podujeve, pn

(Adresa)

Prishtinë **10 000**

(Vendi) *(Kodi postar)*

+38344122204 ***N*/A**

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Valdet Jupolli

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

mesepharm@gmail.com

(Adresa elektronike)

24.03.2025

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K. MESE PHARM 812217421 PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e njoftimit për kontratë: 24.02.2025 Data e planifikuar e hapjes së ofertave: 17.03.2025 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 13.03.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒ x

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒ x

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 27 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 17.7 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt.24.02.2025, kurse hapja e ofertave është planifikuar të bëhet me dt. 17.03.2025.

Gjatë analizës që i kemi bërë dosjes së tenderit kemi ardh në përfundim që në dosje të tenderit janë vendosur kërkesa diskriminuese dhe favorizuese të cilat do ti sqarojmë si në vijim:

Tek kapaciteti teknik dhe profesional në nenin 9.1&9.2 e FDT-së është kërkuar: Kërkesa 3. CE Certifikata. Evidenca 3. CE Certifikata e produktit- kopje

Fillimisht po e sqarojmë se për këtë aktivitet të prokurimit ne kemi parashtruar kërkesë për informacione shtesë me dt.05.03.2025, si më poshtë:

-Tek Lot1, produkti Kompresa (qarshafa per nje perdorim) jo steril, Me llastek 90x210, eshte produkt josteril dmth i klases 1, ku nuk kerkohet CE Certifikata as ne importimin e tij andaj kerkojme nga ju qe te largohet kerkesa per CE Certifikate dhe te lejohet te ofertohet me Deklerat Konformiteti ne vend te CE certifikates.

-Tek lot4, produkti Hidrogjen 3% 1L (Uji i Oksigjenuar - Peroksidi i Hidrogjenit), eshte dezinfektues i leht 3% dhe nuk eshte paisje ose produkt mjeksor, perdoret per perdorim te jashtem ne Lekure, nuk kerkohet CE certifikat as ne importimin e tij andaj kerkojm nga ju qe te largohet kerkesa per CE certifikate dhe te lejohet te ofertohet me Deklerat Konformiteti ne vend te CE certifikates.

Përgjigje:
Kërkesat e vendosura ne këtë aktivitet te prokurimit janë te bazuara nga praktikat e me hershme, ku produktet e tenderuara kane pasur CE Certifikatë, prandaj ofertuesit udhëzohen qe ti referohen Kërkesave te Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit.

Kërkesa e lartcekur është e përgjithësuar dhe nuk përkon me të gjitha materialet që kërkohen, prandaj konsiderojmë se duhet ndryshuar, ndërsa për disa materiale që janë të klases së parë të kërkohet deklarata e konformitetit.

P.sh Tek specifikimet teknike është kërkuar Kompresa (qarshafa per nje perdorim) jo steril, Me llastek 90x210, e që është produkt i klasit të parë me potencial të ultë të rrezikut për përdoruesit, produkti perdoret tek dysheku e jo tek pacienti, është thjeshte një mbulese me mbrojt dyshekun nga njollat e mundeshme dhe nuk paraqet ndonjë rrezik tek pacientët.

Në lidhje me këtë produkt sipas Procedures Standarde Operative: Importi i Pajisjeve
Medicinale nga AKPPM-Ministria e Shëndetësisë, për import ne Kosove kërkohet deklarata e konformitetit e shoqëruar me certifikatë për standardet e cilësisë - Iso Certifikatë.

Duke pasur parasysh këto sqarime kemi kërkuar nga AK-së e tani po kërkojmë edhe nga OSHP që të ndryshohet kjo kërkesë dhe të lejohet të ofertohet me deklaratë të konformitetit për produktet në fjalë që janë të klasit të parë.

Në rast se nuk ndryshohet kërkesa e lartcekur, atëherë po favorizohet një OE i caktuar i cili mund te posedon CE certifikatë për këtë produkt. Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura, kërkojmë që të ndryshohet kërkesa e lartcekur duke u lejuar të prezantohet edhe deklarata e konformitetit si dëshmi për të plotësuar këtë kërkesë. Pra kërkojmë ose të zëvendësohet CE certifikata me deklaratë të konformitetit ose të lejohet opcionale dhe të kërkohet CE certifikatë ose deklaratë e konformitetit.

Vendimin për refuzim e kemi pranuar me dt.13.03.2025, ku është aprovuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim mirëpo AK-së ka vazhduar me aktivitetin e prokurimit dhe nuk e ka kthyer lëndën në

rishqyrtim. Realisht AK-së ka aprovuar pjesërisht pretendimin tonë ankimor ku kemi kërkuar që të lejohet të ofertohet me deklaratë të konformitetit për produktet e klasit të parë, ndërsa AK-së e ka mundësuar tani ofertimin me deklaratë konformiteti vetëm për produktin Hidrogjen 3% tek lot 4, mirëpo nuk a lejuar që të ofrohet deklarata e konformitetit edhe për produktet tjera të klasit të parë, e ku ne e kemi cekur p.sh edhe kompresat jo sterile tek Lot 1.
Nga ky fakt kuptohet qartë se autoriteti kontraktues ka shpreh njëanshmëri dhe subjektivizëm në përpilim të kërkesave kualifikuese, prandaj me këtë veprim të AK-së kuptohet qartë tendenca favorizuese për kompani të caktuara dhe kufizimi i konkurrencës.
Sa i përket kërkesës për Lot 1 AK-së është përgjigjur si më poshtë:

Përgjigje ne pretendimet e OE Ankues:

1. Lidhur me pretendimet qe kane te bëjnë me Lot 1, AK-QKUK i konsideron si te pabazuara, për faktin se ka shume prodhues qe kane CE Certifikate për produktet e Lotit 1, ndërsa ofertuesit duhet tu përshtaten kërkesave te cilësisë se AK-së, dhe te ofertojnë me produkte cilësore.

Kjo përgjigje është joprofesionale sepse cilësia e produktit vie në shprehje edhe nëse ofrohet deklarata e konformitetit, prandaj kjo arsye është e paqëndrueshme.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".
Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit dhe nuk mund të ketë konkurrencë të hapur.
Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 të LPP-së parasheh qartë: Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit".

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me lëndën dhe qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik që eventualisht mund ti përshtaten këto kërkesa, automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet fituesi me këto kërkesa.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se dosja e tenderit nuk është përpiluar në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është pas parasysh as nenin 17.7 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve".

Duke u bazuar në të gjitha këto kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse aty shkruan qartë se "Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike".

Me këto kërkesa, jo vetëm që nuk i është kushtuar rëndësi operatorëve ekonomik të ri, por i është kufizuar konkurrenca edhe operatorëve ekonomik me përvojë dhe me stabilitet ekonomiko financiar dhe me aftësi teknike profesionale, prandaj duhet ndryshuar/larguar këto kërkesa që të mundësohet pjesëmarrje më e gjerë e operatorëve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e **MESE PHARM SH.P.K**
NDRYSHOHEN kërkesat, që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Nuk ka

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*